<p>mundëson qasje në ato të dhëna. Këto të dhëna lidhen me identifikimin unik të lëndës plasëse, duke përfshirë vendndodhjen e saj përderisa është në zotërim të operatorëve ekonomikë si dhe identitetin e operatorit ekonomik.</p> <p>4. Të dhënat nga paragrafi 3 i këtij neni testohen në intervale të rregullta dhe mbrohen nga dëmtimet ose shkatërrimet aksidentale ose të qëllimshme.</p> <p>5. Këto të dhëna ruhen për dhjetë (10) vjet pas kryerjes së transaksionit, përdorimit ose asgjësimit edhe nëse operatori ekonomik ka ndërprerë aktivitetin me lëndët plasëse dhe i vihen në dispozicion menjëherë autoriteteve kompetente, në bazë të kërkesës.</p> <p>6. Për zbatimin e këtij neni Ministri i MPB-së nxjerr akt nënligjor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Procedura e vlerësimit të përputhshmërisë</p> <p>1. Për vlerësimin e përputhshmërisë së lëndëve plasëse, operatori ekonomik duhet të ndjekë një nga procedurat e mëposhtme:</p>	<p>to the related data. This data is related to the unique identification of the explosive, including its location while in the possession of economic operators and the identity of those economic operators.</p> <p>4. The data from paragraph 3 of this Article are regularly tested and safeguarded against accidental or intentional damage or destruction.</p> <p>5. This data must be retained for ten (10) years after the transaction, use or disposal, even if the economic operator has ceased activity with explosives, and it is immediately made available to the competent authorities upon request.</p> <p>6. For the implementation of this Article, the Minister of MIA shall issue a sub-legal act.</p> <p style="text-align: center;">Article 14 Conformity assessment procedure</p> <p>1. To conduct the conformity assessment of explosives, the economic operator must follow one of the following procedures:</p>	<p>njeno pakovanje koje omogućava pristup na te podatke. Ovi podaci se vežu na jedinstvenu identifikaciju eksplozivne materije, uključujući njegovu lokaciju dok je u posedu ekonomskih operatera kao i identitet ekonomskog operatera.</p> <p>4. Podaci iz stava 3 ovog člana se testiraju u redovnim intervalima i štite od slučajnog ili namernog oštećenja ili uništenja.</p> <p>5. Ovi podaci se čuvaju za deset (10) godina nakon obavljanja transakcije, upotrebe ili uništavanja, i ako je ekonomski operater prekinuo aktivnost sa eksplozivom materijom i stavljaju se odmah na raspolaganju nadležnim autoritetima, na osnovu zahteva.</p> <p>6. Za sprovođenje ovog člana Ministar MUP-a donosi podzakonski akt.</p> <p style="text-align: center;">Član 14 Postupak procenjivanja usklađenosti</p> <p>1. Za procenu usklađenosti eksplozivne materije, ekonomski operater mora slediti jedan od sledećih postupaka:</p>
---	---	--

<p>1.1. Procedurën sipas modelit të BE-së dhe sipas zgjedhjes të operatorit ekonomik, një nga procedurat më poshtë:</p> <p>1.1.1. përputhshmërinë sipas llojit, e bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit dhe kontrollet e mbikëqyrura të produktit në intervale të rastësishme;</p> <p>1.1.2. përputhshmërinë sipas llojit, e bazuar në sigurimin e cilësisë së procesit të prodhimit;</p> <p>1.1.3. përputhshmërinë sipas llojit, e bazuar në sigurimin e cilësisë së produktit;</p> <p>1.1.4. përputhshmërinë e bazuar në verifikimin e produktit.</p> <p>1.2. përputhshmërinë e bazuar në verifikimin individual të produktit.</p> <p>2. Procedura për vlerësimin e përputhshmërisë përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri i MPB-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Deklarata e përputhshmërisë</p> <p>1. Deklarata e përputhshmërisë e hartuar nga operatori ekonomik për lëndët plasëse duhet të përmbajë kriteret thelbësore të</p>	<p>1.1. The procedure according to the EU model and the choice of the economic operator, one of the procedures below:</p> <p>1.1.1. conformity by type, based on internal production control and supervised product controls at random intervals;</p> <p>1.1.2. conformity by type, and based on the production process quality assurance;</p> <p>1.1.3. conformity by type, and based on product quality assurance;</p> <p>1.1.4. conformity based on product verification.</p> <p>1.2. conformity based on individual product verification.</p> <p>2. The conformity assessment procedure shall be determined by a sub-legal act issued by the Minister of MIA.</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Declaration of conformity</p> <p>1. The economic operator shall prepare the declaration of conformity for explosives, including essential safety criteria, in the</p>	<p>1.1. Postupak prema modelu EU-a i prema izboru ekonomskog operatera, jedan od postupaka u nastavku:</p> <p>1.1.1. usklađenost prema vrsti, na osnovu unutrašnje kontrole proizvodnje i nadziranih kontrola proizvoda u slučajnim intervalima;</p> <p>1.1.2. usklađenost prema vrsti, na osnovu obezbeđivanja kvaliteta proizvodnog procesa;</p> <p>1.1.3. usklađenost prema vrsti, na osnovu obezbeđivanja kvaliteta proizvoda;</p> <p>1.1.4. usklađenost bazirana na verifikaciji proizvoda.</p> <p>1.2. usklađenost bazirana na pojedinačnu verifikaciju proizvoda.</p> <p>2. Postupak za procenu usklađenosti utvrđuje se podzakonskim aktom donetim od Ministra MUP-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Izjava o usklađenosti</p> <p>1. Izjava o usklađenosti izrađena od ekonomskog operatera za eksplozivne materije mora sadržati suštinske kriterijume</p>
--	---	---

<p>sigurisë dhe sipas formatit të përcaktuar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri i MPB-së.</p> <p>2. Me nënshkrimin e deklaratës së përputhshmërisë operatori ekonomik merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit me dispozitat e këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Rregullat dhe kushtet për vendosjen e shenjës CE</p> <p>1. Shenja CE duhet të vendoset në mënyrë të dukshme të lëndët plasëse, të jetë e lexueshme dhe e pashlyeshme. Kur kjo është e pamundur, shenjimi duhet vendoset në ambalazh dhe në dokumentet shoqëruese.</p> <p>2. Shenja CE duhet të fiksohet përpara se lënda plasëse të vendoset në treg.</p> <p>3. Shenja CE shoqërohet nga një numër identifikimi i organit evropian të vlerësimit të përputhshmërisë që është përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit.</p> <p>4. Numri i identifikimit vendoset nga vetë organi ose sipas udhëzimeve të tij nga ana e prodhuesit ose përfaqësuesit të autorizuar të këtij të fundit.</p>	<p>format specified by the Minister of MIA in a sub-legal act.</p> <p>2. By signing the declaration of conformity, the economic operator shall undertake responsibility for the product's conformity with the provisions of this law.</p> <p style="text-align: center;">Article 16 Rules and conditions for affixing the CE marking</p> <p>1. The CE marking shall be affixed visibly, legibly and indelibly to the explosive. Where that is not possible or not warranted, it shall be affixed to the packaging and to the accompanying documents.</p> <p>2. The CE marking shall be affixed before the explosive is placed on the market.</p> <p>3. The CE marking shall be followed by an identification number of the European conformity assessment body that is involved in the production control phase.</p> <p>4. The identification number shall be affixed by the body itself or, under its instructions, by the manufacturer or his authorized representative.</p>	<p>bezbednosti i prema formatu utvrđenim podzakonskim aktom donetim od Ministra MUP-a.</p> <p>2. Potpisivanjem izjave o usklađenosti ekonomski operater preuzima odgovornost za usklađenost proizvoda sa odredbama ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 16 Pravila i uslovi za stavljanje CE oznake</p> <p>1. CE oznaka se mora postaviti na vidljiv način na eksplozivne materije, biti čitljiva i neizbrisiva. Kada to nije moguće, oznaka se mora staviti na ambalažu i na pratećim dokumentima.</p> <p>2. CE oznaka se mora fiksirati pre nego što se eksplozivna materija stavi na tržište.</p> <p>3. Oznaku CE se prati od identifikacionog broja Evropskog organa za procenu usaglašenosti, koji je uključen u fazu kontrole proizvodnje.</p> <p>4. Identifikacioni broj se postavlja od samog organa ili prema njegovim uputstvima od strane proizvođača ili ovlašćenog zastupnika ovog poslednjeg.</p>
--	--	---

<p>5. Shenja CE dhe numri i organit evropian të vlerësimit të përputhshmërisë, kur është e mundur, shoqërohet edhe nga një shenjë tjetër që tregon rrezik apo përdorim të veçantë.</p> <p>6. Për zbatimin e këtij neni Ministri i MPB-së nxjerr akt nënligjor.</p>	<p>5. The CE marking and, where applicable, the identification number of the European conformity assessment body may be followed by any other mark indicating a special risk or use.</p> <p>6. For the implementation of this Article, the Minister of MIA shall issue a sub-legal act.</p>	<p>5. CE oznaka i broj Evropskog organa za procenjivanje usaglašenosti, kada je moguće se prati i od drugog znaka koji pokazuje opasnost ili posebnu upotrebu.</p> <p>6. Za sprovođenje ovog člana Ministar MUP-a donosi podzakonski akt.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 17 Organet e vlerësimit të përputhshmërisë</p> <p>1. Vlerësimi i përputhshmërisë së lëndëve plasëse bëhet nga vetë prodhuesi nëpërmjet një organi evropian të vlerësimit të përputhshmërisë.</p> <p>2. Lënda plasëse mund të vendoset në treg nëse i përmbush të gjitha standardet e sigurisë dhe nëse organi evropian i vlerësimit të përputhshmërisë vërteton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në standardet e harmonizuara të Bashkimit Evropian.</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 Conformity assessment bodies</p> <p>1. The manufacturer shall conduct the conformity assessment of explosives through a European conformity assessment body.</p> <p>2. Explosives may be made available on the market if they meet all safety standards and if the European conformity assessment body certifies conformity with the criteria outlined in the European Union harmonized standards.</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Organi za procenu usklađenosti</p> <p>1. Procena usklađenosti eksplozivne materije se vrši od samog proizvođača preko evropskog organa za procenu usklađenosti.</p> <p>2. Eksplozivna materija se može staviti na tržište ako ispunjava sve bezbednosne standarde i ako evropski organ za procenu usklađenosti potvrdi usklađenost sa kriterijumima utvrđenim u usklađenim standardima Evropske unije.</p>

<p>KAPITULLI IV LEJET</p> <p>Nënkapitulli 1 Llojet e lejeve dhe kushtet e përgjithshme</p> <p>Neni 18 Lejet për lëndët plasëse dhe artikujt piroteknikë</p> <p>1. MPB lëshon leje sipas kërkesës së operatorit ekonomik, si në vijim:</p> <p>1.1. leje për testim të lëndëve plasëse;</p> <p>1.2. leje për prodhim të lëndëve plasëse;</p> <p>1.3. leje për kërkim dhe hulumtim të lëndëve plasëse;</p> <p>1.4. leja për shpërthim të lëndëve plasëse;</p> <p>1.5. leje për import, eksport, transit ose transferimin të lëndëve plasëse;</p> <p>1.6. leje për asgjësim të lëndëve plasëse;</p>	<p>CHAPTER IV PERMITS</p> <p>Sub-chapter 1 Types of permits and general conditions</p> <p>Article 18 Permits for explosives and pyrotechnic articles</p> <p>1. At the request of economic operators, the MIA issues the following permits:</p> <p>1.1. permit for testing explosives;</p> <p>1.2. permit for production of explosives;</p> <p>1.3. permit for search and research of explosives;</p> <p>1.4. permit for explosion of explosives;</p> <p>1.5. permit for import, export, transit or transfer of explosives;</p> <p>1.6. permit for destruction of explosives;</p>	<p>POGLAVLJE IV DOZVOLE</p> <p>Potpoglavlje 1 Vrste dozvola i opšti uslovi</p> <p>Član 18 Dozvole za eksplozivne materije i pirotehnička sredstva</p> <p>1. MUP izdaje dozvole na zahtev ekonomskog operatera, kao u nastavku:</p> <p>1.1. dozvola za testiranje eksplozivnih materija;</p> <p>1.2. dozvola za proizvodnju eksplozivnih materija;</p> <p>1.3. dozvola za pretragu i istraživanje eksplozivnih materija;</p> <p>1.4. dozvola za eksploziju eksplozivnih materija;</p> <p>1.5. dozvola za uvoz, izvoz, tranzit ili prenos eksplozivnih materija;</p> <p>1.6. dozvola za uništenje eksplozivnih materija;</p>
--	---	---

<p>1.7. leje për magazinim të lëndëve plasëse;</p> <p>1.8. leje për shitje të lëndëve plasëse;</p> <p>1.9. leje për testim të artikujve piroteknikë;</p> <p>1.10. leje për kërkim dhe hulumtim të artikujve piroteknikë;</p> <p>1.11. leje për prodhim të artikujve piroteknikë;</p> <p>1.12. leje për import, eksport, transit ose transferimin e artikujve piroteknikë;</p> <p>1.13. leje për asgjësim të artikujve piroteknikë;</p> <p>1.14. leje për magazinim të artikujve piroteknikë;</p> <p>1.15. leje për ndezje profesionale të artikujve piroteknikë të kategorisë F4, T2 dhe P2;</p> <p>1.16. leje për dyqan të shitjes me pakicë të mjeteve piroteknike.</p> <p>2. Lejet mund të jepen për një ose më shumë veprimtari, për një periudhë pesë (5) vjeçare,</p>	<p>1.7. permit for storage of explosives;</p> <p>1.8. permit for sale of explosives;</p> <p>1.9. permit for testing of pyrotechnic articles;</p> <p>1.10. permit for search and research of pyrotechnic articles;</p> <p>1.11. permit for production of pyrotechnic articles;</p> <p>1.12. permit for import, export, transit or transfer of pyrotechnic articles;</p> <p>1.13. permit for destruction of pyrotechnic articles;</p> <p>1.14. permit for storage of pyrotechnic articles;</p> <p>1.15. permit for professional ignition of pyrotechnic articles of category F4, T2 and P2;</p> <p>1.16. permit for retail store of pyrotechnics.</p> <p>2. Permits may be granted for one or more activities for a period of five (5) years,</p>	<p>1.7. dozvola za skladištenje eksplozivnih materija;</p> <p>1.8. dozvola za prodaju eksplozivnih materija;</p> <p>1.9. dozvola za testiranje pirotehničkih sredstava;</p> <p>1.10. dozvola za pretragu i istraživanje pirotehničkih sredstava;</p> <p>1.11. dozvola za proizvodnju pirotehničkih sredstava;</p> <p>1.12. dozvola za uvoz, izvoz, tranzit ili prenos pirotehničkih sredstava;</p> <p>1.13. dozvola za uništenje pirotehničkih sredstava;</p> <p>1.14. dozvola za skladištenje pirotehničkih sredstava;</p> <p>1.15. dozvola za profesionalno paljenje pirotehničkih sredstava kategorije F4, T2 i P2;</p> <p>1.16. dozvola za prodavnicu maloprodaje pirotehničkih sredstava.</p> <p>2. Dozvole se mogu izdati za jednu ili više delatnosti, na period od pet (5) godina, u</p>
---	---	--

<p>varësisht nga kërkesa e operatorit ekonomik dhe plotësimi i kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë ligj.</p> <p>3. Procedura për pajisje me leje sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta si dhe rregullat e tjera sipas këti ligji, përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Ministri i MPB-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 19 Kriteret e përgjithshme për pajisje me leje</p> <p>1. Për tu pajisur me leje sipas nenit 18 të këtij ligji, personi fizik apo juridik duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:</p> <p>1.1. të ketë certifikatën e regjistrimit të biznesit;</p> <p>1.2. të ketë dëshmi nga gjykata se personit nuk i është ndaluar ose ndërprerë aktiviteti me vendim të formës së prerë;</p> <p>1.3. të ketë garancionin bankar pesë (5) vjeçar me vlerë të dhjetëmijë (10.000) Euro;</p> <p>1.4. personi i autorizuar të plotësojë kriteret nga neni 8 i këtij Ligji.</p>	<p>depending on the request of the economic operator and the fulfillment of the general and specific criteria defined by this law.</p> <p>3. The procedure for obtaining a permit according to general and specific criteria, as well as other rules according to this law, is determined by a sub-legal act approved by the Minister of MIA.</p> <p style="text-align: center;">Article 19 General criteria for obtaining a permit</p> <p>1. To obtain a permit in accordance with Article 18 of this Law, a natural or legal person must meet the following criteria:</p> <p>1.1. possess a valid business registration certificate;</p> <p>1.2. provide a certificate from the court confirming that the person's activities have not been prohibited or interrupted by a final decision;</p> <p>1.3. provide a five (5) year bank guarantee of ten thousand (10,000) Euros;</p> <p>1.4. the authorized person must meet the criteria outlined in Article 8 of this Law.</p>	<p>zavisnosti od zahteva ekonomskog operatera i ispunjavanje opštih i posebnih kriterijuma utvrđenih ovim zakonom.</p> <p>3. Postupak za opremanje sa dozvolom prema opštini i posebnim kriterijumima, kao i drugim pravilima prema ovom zakonu, utvrđuje se podzakonskim aktom usvojenim od Ministra MUP-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 19 Opšti kriterijumi za opremanje dozvolom</p> <p>1. Za opremanje dozvolom prema članu 18 ovog zakona, fizičko ili pravno lice mora da ispunjava kriterijume kao dole:</p> <p>1.1. da ima sertifikat o registraciji biznisa;</p> <p>1.2. da ima dokaze od suda da licu nije zabranjena ili prekinuta aktivnost pravosnažnom odlukom;</p> <p>1.3. da ima bankarsku garanciju od pet (5) godina sa vrednošću od deset hiljada (10.000) evra;</p> <p>1.4. lice ovlašćeno da ispunjava kriterijume iz člana 8 ovog Zakona.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Nënkapitulli 2 Kriteret e veçanta për pajisje me leje për lëndë plasëse</p> <p style="text-align: center;">Neni 20 Leja për testimin e lëndëve plasëse</p> <p>1. Operatori ekonomik ose prodhuesi mund të kryejë testime të lëndëve plasëse për nevojat e tyre profesionale në procedurën e vlerësimit të përputhshmërisë, pasi të kenë marrë lejen për testim.</p> <p>2. Leja nga paragrafi 1 i këtij neni i lëshohet operatorit ekonomik pasi t'i ketë plotësuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta si në vijim:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. të ketë të angazhuar persona të kualifikuar që do të trajtojnë lëndët plasëse gjatë testimit;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. të ketë lejen e posedimit apo të përdorimit të laboratorit për testim të lëndëve plasëse;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. të ketë në pronësi apo të drejtën për të përdorur hapësirën ose objektin për testimin e lëndëve plasëse në vendin ku kryhet testimi;</p>	<p style="text-align: center;">Sub-chapter 2 Specific criteria for obtaining a permit for explosives</p> <p style="text-align: center;">Article 20 Permit for testing explosives</p> <p>1. The economic operator or manufacturer shall conduct explosives testing for their professional requirements during the conformity assessment process, after having obtained a permit for testing.</p> <p>2. The permit from paragraph 1 of this Article will be issued to the economic operator once they have met the following specific criteria, in addition to the general criteria:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. employ qualified individuals to handle explosives during testing;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. have permission to possess or use the laboratory for testing explosives;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. own or have the right to use the space or facility for testing explosives in the location where the testing is conducted;</p>	<p style="text-align: center;">Potpoglavlje 2 Posebni kriterijumi za opremanje sa dozvolom za eksplozivne materije</p> <p style="text-align: center;">Član 20 Dozvola za testiranje eksplozivnih materija</p> <p>1. Ekonomski operater ili proizvođač može izvršiti testiranja eksplozivnih materija za svoje stručne potrebe u postupku procenjivanja usklađenosti, nakon što dobiju dozvolu za testiranje.</p> <p>2. Dozvola iz stava 1. ovog člana izdaje se ekonomskom operateru nakon što bude ispunio opšte kriterijume i posebne kriterijume kao u nastavku:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. da ima angažovana kvalifikovana lica koja će tretirati eksplozivne materije tokom testiranja;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. da ima dozvolu za posedovanje ili korišćenje laboratorije za testiranje eksplozivnih materija;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. da ima u vlasništvu ili pravo korišćenja prostora ili objekta za testiranje eksplozivnih materija u mestu gde se vrši testiranje;</p>
--	---	--

<p>2.4. të ketë në pronësi, ose lejen për të përdorur magazinën për qëllime të përcaktuara;</p> <p>2.5. leje të magazinimit ose dëshmi të posedimit të një magazine të përkohshme të ndërtuar brenda laboratorit të testimit.</p> <p>3. Operatori ekonomik që kryen testimin e lëndës plasëse sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të njoftojë MPB-në për marrjen e mostrave të lëndës plasëse për qëllime të testimit, jo më vonë se shtatëdhjetëdy (72) orë para testimit.</p> <p>4. Nëse një operator ekonomik ka lejen për prodhim të lëndëve plasëse, mund të kryejë teste të lëndëve plasëse me qëllim të kontrollit të prodhimit të tij pa leje testimi.</p>	<p>2.4. own or have a permit to use the warehouse for specified purposes;</p> <p>2.5. have a storage permit or evidence of possession of a temporary storage (warehouse) built within the testing laboratory.</p> <p>3. The economic operator conducting explosive testing in accordance with paragraph 1 of this Article must notify the MIA about taking samples of the explosives for testing purposes at least seventy-two (72) hours before testing.</p> <p>4. If an economic operator holds a permit for the production of explosives, they are allowed to conduct explosive testing to control their production without needing a test permit.</p>	<p>2.4. da ima u vlasništvu, ili dozvolu za korišćenje skladišta za utvrđene svrhe;</p> <p>2.5. dozvola za skladištenje ili dokaz o posedovanju privremenog skladišta izgrađenog unutar laboratorije za testiranje.</p> <p>3. Ekonomski operater koji obavlja testiranje eksplozivne materije prema stavu 1. ovog člana treba da obavesti MUP o uzimanju uzoraka eksplozivne materije za svrhe testiranja, ne kasnije od sedamdeset dva (72) sata pre testiranja.</p> <p>4. Ako ekonomski operater ima dozvolu za proizvodnju eksplozivnih materija, može obavljati testove eksplozivnih materija sa ciljem kontrole svoje proizvodnje bez dozvole testiranja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 21 Leja për prodhim të lëndëve plasëse</p> <p>1. Operatori ekonomik mund të fillojë prodhimin e lëndëve plasëse pasi të jetë pajisur me lejen për prodhimin e lëndëve plasëse.</p> <p>2. Leja nga paragrafi 1 i këtij neni i lëshohet operatorit ekonomik pasi t'i ketë plotësuar</p>	<p style="text-align: center;">Article 21 Permit for production of explosives</p> <p>1. The economic operator may begin with the production of explosives after having obtained the permit for the production of explosives.</p> <p>2. The permit from paragraph 1 of this Article shall be granted to the economic</p>	<p style="text-align: center;">Član 21 Dozvola za proizvodnju eksplozivnih materija</p> <p>1. Ekonomski operater može započeti proizvodnju eksplozivnih materija nakon što se opremi dozvolom za proizvodnju eksplozivnih materija.</p> <p>2. Dozvola iz stava 1. ovog člana izdaje se ekonomskom operateru nakon što bude</p>

<p>kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta si në vijim:</p> <p>2.1. të jetë i pajisur me leje për magazinim;</p> <p>2.2. të jetë i pajisur me lejen e ndërtimit për objektet ku prodhohen lëndët plasëse;</p> <p>2.3. të ketë pëlqim mjedisor;</p> <p>2.4. të ketë leje mjedisore;</p> <p>2.5. të ketë plan emergjent të aprovuar nga organi kompetent;</p> <p>2.6. të ketë plan të sigurisë së vendndodhjes, të aprovuar nga organi kompetent;</p> <p>2.7. të ofrojë të dhënat për llojin e lëndëve plasëse që planifikohen të prodhohen;</p> <p>2.8. të ofrojë të dhënat për procesin dhe teknologjinë e prodhimit;</p> <p>2.9. të ketë të angazhuar persona të autorizuar dhe të kualifikuar;</p> <p>2.10. të ketë të dhënat teknologjike mbi procesin e prodhimit;</p>	<p>operator once they have met the general and specific criteria outlined below:</p> <p>2.1. have a storage permit;</p> <p>2.2. have a construction permit for facilities where explosives are produced;</p> <p>2.3. have environmental consent;</p> <p>2.4. have an environmental permit;</p> <p>2.5. have an emergency plan approved by the competent body;</p> <p>2.6. have a site security plan approved by the competent body;</p> <p>2.7. provide data on the type of explosives planned to be produced;</p> <p>2.8. provide data on the production process and technology;</p> <p>2.9. hire authorized and qualified individuals;</p> <p>2.10. have technological data on the production process;</p>	<p>ispunio opšte kriterijume i posebne kriterijume kao u nastavku:</p> <p>2.1. da bude opremljen dozvolom za skladištenje;</p> <p>2.2. da bude opremljen građevinskom dozvolom za objekte gde se proizvode eksplozivne materije;</p> <p>2.3. da ima saglasnost životne sredine;</p> <p>2.4. da ima dozvolu životne sredine;</p> <p>2.5. da ima plan za vanredne situacije odobren od nadležnog organa;</p> <p>2.6. da ima plan bezbednosti lokacije, odobren od nadležnog organa;</p> <p>2.7. da pruža podatke o vrsti eksplozivnih materija koji se planiraju proizvoditi;</p> <p>2.8. da pruža podataka o proizvodnom procesu i tehnologiji;</p> <p>2.9. da ima angažovana ovlašćena i kvalifikovana lica;</p> <p>2.10. da ima tehnološke podatke o procesu proizvodnje;</p>
---	--	--

<p>2.11. të ketë të dhënat për sistemin e vetëkontrollit të cilësisë;</p> <p>2.12. të ketë dëshmitë për plotësimin e kushteve nga neni 11 paragrafët 1, 2, 3, 6 këtij ligji.</p> <p>3. Në bazë të lejes së lëshuar për prodhim, lënda plasëse e prodhuar i nënshtrohet testimit pas gjashtë (6) muajve në vitin e parë dhe përsëritet testimi çdo dymbëdhjetë (12) muaj.</p> <p>4. Kriteret nga paragrafi 2 i këtij neni nuk vlejné për:</p> <p>4.1. prodhimin e lëndëve plasëse për qëllime të analizave laboratorike, testimin, demonstrimin ose eksperimentin ku sasia totale e lëndëve plasëse që prodhohet në çdo kohë nuk tejkalon njëqind (100) gram;</p> <p>4.2. prodhimin ose asgjësimin e municionit të armëve të vogla ose përgatitjen e fishekëve për përdorim me armë zjarri, që përdoren për shënim të ngjarjeve historike, ku sasia totale e mbushësit dhe shtytësit të përdorur në çdo kohë nuk tejkalon dy (2) kilogram dhe për këto qëllime sasia e shtytësit të</p>	<p>2.11. have data for its own quality control system;</p> <p>2.12. have evidence of meeting conditions from Article 11, paragraphs 1, 2, 3, and 6 of this Law.</p> <p>3. According to the production permit issued, the explosives produced shall be tested after six (6) months in the first year, with subsequent testing required every twelve (12) months.</p> <p>4. The criteria from paragraph 2 of this Article shall not apply to the following:</p> <p>4.1. production of explosives for the purposes of laboratory analysis, testing, demonstration, or experimentation, as long as the total amount of explosives produced does not exceed one hundred (100) grams at any time;</p> <p>4.2. manufacturing or destruction of small arms ammunition or the preparation of cartridges for firearms use, which are used for marking historical events, where the total amount of filler and propellant used does not exceed two (2) kilograms at any time, and for such purposes the amount of</p>	<p>2.11. da ima podatke o sistemu samokontrole kvaliteta;</p> <p>2.12. da ima dokaze o ispunjavanju uslova iz člana 11. stava 1, 2, 3, 6. ovog zakona.</p> <p>3. Na osnovu izdate dozvole o proizvodnji, proizvedena eksplozivna materija podleže testiranju nakon šest (6) meseci u prvoj godini, a testiranje se ponavlja svakih dvanaest (12) meseci.</p> <p>4. Kriterijumi iz stava 2. ovog člana ne važe za:</p> <p>4.1. proizvodnju eksplozivnih materija za svrhe laboratorijskih analiza, testiranja, demonstracije ili eksperimentiranja, gde ukupna količina eksplozivnih materija koje se proizvede u svako vreme ne prelazi sto (100) grama;</p> <p>4.2. proizvodnju ili uništavanje municije za mala oružja ili pripremu patrona za upotrebu sa vatrenim oružjem, koji se koriste za obeležavanje istorijskih događaja, gde je ukupna količina punila i pogonskog goriva korišćenog u svako vreme ne prelazi dva (2) kilograma i za te svrhe količina</p>
--	--	--

<p>përdorur përfshin shtytësin e larguar nga fisheku;</p> <p>4.3. përgatitjen e mbushjeve për shkrepje në lidhje me përdorimin e tyre;</p> <p>4.4. përgatitjen, montimin, çmontimin dhe vëndosjen e kapsollës në përdorimin e fishekzjarrëve në vendet e planifikuara për përdorim;</p> <p>4.5. përgatitjen, montimin dhe aktivizimin e kapsollës së fishekzjarrëve, në sasi deri në dhjetë (10) kilogram, në çdo kohë, në vendin ku personi juridik posedon lejen për magazinim të lëndëve plasëse për qëllim të përdorimit të fishekzjarrëve;</p> <p>4.6. përgatitjen, montimin dhe aktivizimin e kapsollës së lëndës plasëse për përdorim në shfaqje teatrale, televizive ose kinematografike;</p> <p>4.7. ripërpunimin e lëndëve plasëse për të formuar një produkt farmaceutik që në vetvete nuk është lëndë plasëse;</p> <p>4.8. përzierjen për përdorim të menjëhershëm të nitratis të amonit me karburant, ose lëndëve plasëse nga nitrati i amonit me substancë tjetër në minierë</p>	<p>propellant used includes the propellant removed from the cartridge;</p> <p>4.3. preparation of cartridges for shots related to their use;</p> <p>4.4. preparation, assembly, disassembly, and placing of the capsule in the use of fireworks in locations planned to be used;</p> <p>4.5. preparation, assembly and activation of firework capsules, in quantities not exceeding ten (10) kilograms at any time, at the location where the legal entity holds the permit for storing explosives for the purpose of using fireworks;</p> <p>4.6. preparation, assembly and activation of explosive capsules for use in theatrical, television or cinema performances;</p> <p>4.7. reprocessing explosives to produce a pharmaceutical product that is not an explosive product itself;</p> <p>4.8. mixing ammonium nitrate with fuel for immediate use, or explosives made from ammonium nitrate with another substance in a mine or quarry, to</p>	<p>korišćenog pogonskog goriva uključuje pogonsko gorivo uklonjeno iz uloška;</p> <p>4.3. pripremu patrona za ispaljivanje u vezi na njihovu upotrebu;</p> <p>4.4. pripremu, montažu, demontažu i postavljanje kapsule za upotrebu vatrometa na mestima planiranim za upotrebu;</p> <p>4.5. pripremu, montažu i aktiviranje vatrometne kapsule, u količini do deset (10) kilograma, u svako vreme, na mestu gde pravno lice poseduje dozvolu za skladištenje eksplozivnih materija za svrhu upotrebe vatrometa;</p> <p>4.6. pripremu, montažu i aktiviranje kapsule eksplozivne materije za upotrebu u pozorišnim, televizijskim ili bioskopskim predstavama;</p> <p>4.7. ponovnu preradu eksplozivnih materija za formiranje farmaceutskog proizvoda koji sam po sebi nije eksplozivna materija;</p> <p>4.8. mešavinu za neposrednu upotrebu amonijum nitrata sa gorivom, ili eksplozivnim materijama iz amonijum nitrata sa drugom supstancom u rudniku</p>
--	---	---

<p>ose gurëthyes, për të prodhuar lëndë plasëse që nuk ndizet me kapsollë;</p> <p>4.9.përdorimin e lëndëve plasëse joshpërthyesë në prodhim të produkteve të cilët nuk janë lëndë plasëse;</p> <p>4.10. prodhimi i lëndëve plasëse nga një kompani që është në lidhje pronësie me një kompani tjetër në të njëjtën vendndodhje, dhe e cila ka leje për prodhim të lëndëve plasëse dhe prodhimi është në pajtim me kushtet e asaj leje.</p> <p>5. Kriteret për magazinimin e nitratit të amoniit dhe llojeve tjera të plehrave kimike që përmbajnë azot përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga ministri i MPB-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 22 Prodhimi i lëndëve plasëse</p> <p>1. Prodhimi i lëndëve plasëse është procesi që përfshin ruajtjen e lëndëve të para plasëse, prodhimin, përpunimin, përfundimin, transportin dhe ruajtjen e produkteve përfundimtare të lëndëve plasëse nga prodhuesi brenda hapësirës së prodhimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.</p>	<p>create explosives that do not ignite through a capsule;</p> <p>4.9. use of non-explosive explosives in the production of products that are not explosives;</p> <p>4.10. production of explosives by a company owned by another company in the same location, provided that the company has a permit for production of explosives and the production is in accordance with the terms of that permit.</p> <p>5. The criteria for the storage of ammonium nitrate and other types of nitrogen-containing chemical fertilizers are established by a sub-legal act approved by the Minister of MIA.</p> <p style="text-align: center;">Article 22 Production of explosives</p> <p>1. The production of explosives is the process that involves the storage of explosive raw materials, production, their processing, finishing, transportation, and the storage of final explosive products by the manufacturer within the designated production area, and carried out in accordance with the provisions of this law.</p>	<p>ili kamenolomu, za proizvodnju eksplozivne materije koja se ne pali kapsulom;</p> <p>4.9. upotrebu neeksplozivnih eksplozivnih materija u proizvodnji proizvoda koji nisu eksplozive materije;</p> <p>4.10. proizvodnju eksplozivnih materija od kompanije koja je u vlasničku vezu sa drugom kompanijom u istu lokaciju, i koja ima dozvolu za proizvodnju eksplozivnih materija i proizvodnja je u skladu sa uslovima te dozvole.</p> <p>5. Kriterijumi za skladištenje amonijum nitrata i druge vrste hemijskih đubriva koje sadrže azot utvrđuju se podzakonskim aktom usvojenim od ministra MUP-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 22 Proizvodnja eksplozivnih materija</p> <p>1. Proizvodnja eksplozivnih materija je proces koji uključuje čuvanje eksplozivnih sirovina, proizvodnju, preradu, završetak, transport i čuvanje završnih proizvoda eksplozivnih materija od proizvođača unutar proizvodnog prostora, u skladu sa odredbama ovog zakona.</p>
---	---	--

<p>2. Lëndët plasëse mund të ruhen vetëm në ndërtesa dhe ambiente të destinuara për magazinimin e lëndëve plasëse dhe nuk mund të kalojnë kapacitetin maksimal të lejuar për ruajtje.</p> <p>3. Ndërtesat në të cilat prodhohen apo ruhen lëndët plasëse, duhet të jenë të ndërtuara sipas dispozitave të përcaktuara me legjislacionin përkatës për ndërtim.</p> <p>4. Modifikimet në projektim ose në instalimet e prodhimit që janë të lidhura me standardet e harmonizuara të lëndës plasëse apo ndryshimet në specifikimet teknike duhet të jenë pjesë e lejes mjedisore.</p> <p>5. Prodhuesit janë të detyruar që dokumentacionin teknik dhe deklaratën e përputhshmërisë ta ruajnë për një periudhë dhjetë (10) vjeçare pasi lënda plasëse është vendosur në treg.</p>	<p>2. Explosives can only be stored in buildings and facilities specifically intended for the storage of explosives, and the storage capacity must not exceed the maximum limit allowed.</p> <p>3. Buildings where explosives are produced or stored must be constructed in accordance with the provisions specified by the relevant legislation on construction.</p> <p>4. Modifications to design or production installations, which are related to harmonized standards for explosive materials or changes in technical specifications must be included in the environmental permit.</p> <p>5. Manufacturers are required to maintain technical documentation and the declaration of conformity for a period of 10 years after the explosive is placed on the market.</p>	<p>2. Eksplozivne materije se mogu čuvati samo u zgradama i ambijentima namenjenim za skladištenje eksplozivnih materija i ne mogu prelaziti maksimalni kapacitet dozvoljen za čuvanje.</p> <p>3. Zgrade u kojima se proizvode ili čuvaju eksplozivne materije moraju biti izgrađene prema odredbama utvrđenim odgovarajućim zakonodavstvom o izgradnji.</p> <p>4. Modifikacije u projektovanju ili u instalacijama proizvodnje, koje su vezane sa usklađenim standardima eksplozivne materije ili promene u tehničkim specifikacijama moraju biti deo dozvole životne sredine.</p> <p>5. Proizvođači su obavezni da čuvaju tehničku dokumentaciju i izjavu o usklađenosti za period od deset (10) godina nakon što je eksplozivna materija stavljena na tržište.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 23 Leja për kërkim dhe hulumtim të lëndëve plasëse</p> <p>1. Prodhuesit e lëndëve plasëse si dhe institucionet shkencore mund të bëjnë kërkim dhe hulumtim të lëndëve plasëse, pasi të jenë pajisur me leje për kërkim dhe hulumtim të lëndëve plasëse.</p>	<p style="text-align: center;">Article 23 Permit for searching and researching explosives</p> <p>1. Producers of explosives, as well as scientific institutions, may carry out research on explosives after obtaining a permit for searching and researching explosives.</p>	<p style="text-align: center;">Član 23 Dozvola za pretragu i istraživanje eksplozivnih materija</p> <p>1. Proizvođači eksplozivnih materija, kao i naučne institucije mogu obavljati pretragu i istraživanje eksplozivnih materija, nakon što se opreme dozvolom za pretragu i istraživanje eksplozivnih materija.</p>

<p>2. Leja nga paragrafi 1 i këtij neni i lëshohet operatorit ekonomik pasi t'i ketë plotësuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta si në vijim:</p> <p>2.1. operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrin shtetëror ose personi përgjegjës duhet të jetë pjesë në një institucion shkencor që ka një veprimtari të regjistruar për të cilën është kërkuar leja;</p> <p>2.2. të ketë të drejtën e shfrytëzimit të objektit në të cilin do të kryhet kërkimi dhe hulumtim i lëndëve plasëse;</p> <p>2.3. të jetë i pajisur me leje magazinimi për objektin në të cilin do të bëhet magazinimi i lëndëve plasëse;</p> <p>2.4. të kenë raportin teknologjik mbi procedurën e kërkimit dhe hulumtimit;</p> <p>2.5. të plotësojnë kriteret nga neni 11, paragrafët 1, 2, 3, 6;</p> <p>2.6. të ketë një sistem të vetin të kontrollit të cilësisë.</p> <p>3. Prodhuesit e lëndëve plasëse, të cilët kanë leje të vlefshme prodhuese, nuk kanë</p>	<p>2. The permit from paragraph 1 of this Article shall be granted to the economic operator once they have met the general and specific criteria outlined below:</p> <p>2.1. the economic operator must be registered in the state register, or the responsible person must be part of a scientific institution with a registered activity for which the permit is being requested;</p> <p>2.2. they must have the right to use the facility where the searching and researching of explosives will take place;</p> <p>2.3. they must possess a permit for using the facility where explosives will be stored;</p> <p>2.4. they must have a technological report outlining searching and researching procedures;</p> <p>2.5. they must meet the criteria outlined in Article 11, paragraphs 1, 2, 3, and 6;</p> <p>2.6. they must have their own quality control system.</p> <p>3. Producers of explosives with a valid production permit are not required to meet</p>	<p>2. Dozvola iz stava 1 ovog člana izdaje se ekonomskom operateru nakon što bude ispunio opšte kriterijume i posebne kriterijume kao u nastavku:</p> <p>2.1. ekonomski operater mora biti registrovan u državni registar ili odgovorno lice mora biti deo u naučnoj instituciji koja ima registrovanu delatnost za koju je zahtevana dozvola;</p> <p>2.2. da ima pravo korišćenja objekta u kojem će se obaviti pretraga i istraživanje eksplozivnih materija;</p> <p>2.3. da bude opremljen dozvolom za skladištenje za objekat u kojem će se vršiti skladištenje eksplozivnih materija;</p> <p>2.4. da imaju tehnološki izveštaj o postupku pretrage i istraživanja;</p> <p>2.5. da ispunjavaju kriterijume iz člana 11. stavovi 1, 2, 3, 6;</p> <p>2.6. da ima sopstveni sistem kontrole kvaliteta.</p> <p>3. Proizvođači eksplozivnih materija, koji imaju važeću dozvolu za proizvodnju,</p>
--	--	--

<p>nevojë të përmbushin kriterin nga nën paragrafi 2.6 i këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 24 Leja për shpërthim</p> <p>1. Operatori ekonomik mund të fillojë aktivitetet e shpërthimeve pasi që të jetë pajisur me lejen për shpërthim të lëndëve plasëse.</p> <p>2. Leja nga paragrafi 1 i këtij neni i lëshohet operatorit ekonomik pasi t'i ketë plotësuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta si në vijim:</p> <p>2.1. të ketë të punësuar të paktën një person që ka certifikim të specifikuar sipas llojit të kërkesës për shpërthim, i cili po ashtu është edhe personi përgjegjës për operacionin e shpërthimit;</p> <p>2.2. të ketë në posedim, ose të gëzojë të drejtën e përdorimit të magazinës për ruajtjen e lëndëve plasëse të nevojshme për operacionet e shpërthimit;</p> <p>2.3. të ofrojë të dhënat për llojin dhe sasinë e lëndëve plasëse të cilat janë planifikuar të përdoren në shpërthim;</p> <p>2.4. të ofrojë planin e sigurisë së lokacionit;</p>	<p>the criteria outlined in sub-paragraph 2.6 of this Article.</p> <p style="text-align: center;">Article 24 Permit for explosion</p> <p>1. The economic operator may begin explosive activities after obtaining the permit for explosion of explosives.</p> <p>2. The permit from paragraph 1 of this Article shall be granted to the economic operator once they have met the general and specific criteria outlined below:</p> <p>2.1. employ at least one person with a specified certification related to the type of explosion being requested, who is also responsible for explosion operations;</p> <p>2.2. have possession of, or enjoy the right to use, a warehouse for storing the explosives required for explosion operations;</p> <p>2.3. provide data (information) on the type and quantity of explosives intended to be used in the explosion;</p> <p>2.4. provide a site security plan;</p>	<p>nemaju potrebe da ispunjavaju kriterijum iz podstava 2.6 ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 24 Dozvola za eksploziju</p> <p>1. Ekonomski operater može da počne sa aktivnostima eksplozije nakon što bude opremljen dozvolom za eksploziju eksplozivnih materija.</p> <p>2. Dozvola iz stava 1. ovog člana izdaje se ekonomskom operateru nakon što bude ispunio opšte kriterijume i posebne kriterijume kao u nastavku:</p> <p>2.1. da ima zaposleno najmanje jedno lice koje ima sertifikat specifikovan prema vrsti zahteva za eksploziju, koje je takođe i lice odgovorno za operaciju eksplozije;</p> <p>2.2. da ima u posedu, ili uživa pravo korišćenja skladišta za čuvanje eksplozivne materije potrebne za operacije eksplozije;</p> <p>2.3. da pruži podatke o vrsti i količini eksplozivnih materija koje su planirane da se koriste u eksploziji;</p> <p>2.4. da pruži plan bezbednosti lokacije;</p>
---	--	--

<p>2.5. të ketë kryer vlerësimin e rrezikut të përgatitur nga personat e kualifikuar;</p> <p>2.6. të ketë planin emergjent të përgatitur nga personat e kualifikuar;</p> <p>2.7. të ketë autorizim mjedisor.</p> <p>3. Para aprovimit të lejes për shpërthim, lokacioni inspektohet nga inspektorët e MPB-së dhe në bazë të raportit të inspektimit merret vendimi për kërkesën e lejes së shpërthimit.</p> <p>4. Leja e lëshuar për shpërthim është e vlefshme për një (1) apo më shumë ditë, sipas aprovimit nga MPB.</p> <p>5. Çdo shpërthim sipas lejes kryhet në koordinim me organet përkatëse të ruajtjes së hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës.</p> <p>6. Shpërthimi mund të kryhet vetëm në lokacionin për të cilin MPB ka lëshuar lejen përkatëse.</p> <p>7. Leja për kryerjen e aktiviteteve të shpërthimit në miniera sipërfaqësore dhe miniera nëntokësore si dhe çdo lloj shpërthimi që ka të bëjë me infrastrukturën e minierave lëshohen nga autoriteti kompetent</p>	<p>2.5. conduct a risk assessment prepared by qualified individuals;</p> <p>2.6. develop an emergency plan prepared by qualified individuals;</p> <p>2.7. obtain environmental authorization.</p> <p>3. Prior to approving the permit for explosion, MIA inspectors shall inspect the location, and based on the inspection report a decision on the request for the explosion permit shall be made.</p> <p>4. The explosion permit issued is valid for one (1) or more days, depending on the approval by the MIA.</p> <p>5. Each explosion, as per the permit, shall be carried out in coordination with the relevant airspace protection bodies of the Republic of Kosovo.</p> <p>6. The explosion shall only take place at the location specified in the permit issued by the MIA.</p> <p>7. The permit for conducting explosion activities in surface mines and underground mines, as well as any type of explosion related to mining infrastructure, is issued by the competent mining authority in</p>	<p>2.5. da je izvršio procenu opasnosti pripremljenu od kvalifikovanih lica;</p> <p>2.6. da ima plan za vanredne situacije pripremljen od kvalifikovanih lica;</p> <p>2.7. da ima ovlašćenje životne sredine.</p> <p>3. Pre odobravanja dozvole za eksploziju, lokacija se inspektuje od inspektore MUP-a i na osnovu izveštaja o inspekciji donosi se odluka o zahtevu dozvole za eksploziju.</p> <p>4. Dozvola izdata za eksploziju je važeća za jedan (1) ili više dana, prema odobrenju od MUP.</p> <p>5. Svaka eksplozija prema dozvoli se obavlja u koordinaciji sa odgovarajućim organima za čuvanje vazdušnog prostora Republike Kosova.</p> <p>6. Eksplozija se može izvršiti samo na lokaciji za koju je MUP izdalo odgovarajuću dozvolu.</p> <p>7. Dozvola za obavljanje aktivnosti eksplozije u površinskim i podzemnim rudnicima, kao i svih vrsta eksplozija koja se odnosi na infrastrukturu ruda, izdaje se od nadležnog autoriteta za rude prema</p>
--	---	---

<p>për miniera sipas kriterëve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni dhe ligjit përkatës për miniera dhe minerale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 25 Llojet e shpërthimeve</p> <p>1. Llojet e shpërthimeve janë:</p> <p>1.1. shpërthimi sipërfaqësor, që mund të jenë:</p> <p>1.1.1. shpërthimi në miniera sipërfaqësore;</p> <p>1.1.2. shpërthimi për qëllim ndërtimi;</p> <p>1.1.3. shpërthimi për thërrmim të shkëmbinjve;</p> <p>1.1.4. shpërthimi për qëllime të shpyllëzimit.</p> <p>1.2. shpërthimi nëntokësor, që përfshin të gjitha aktivitetet e shpërthimeve nëntokësore që kanë për qëllim shfrytëzimin e burimeve minerale;</p> <p>1.3. shpërthimi i veçantë, që përfshin:</p> <p>1.3.1. shpërthimin nënujor;</p>	<p>accordance with the criteria outlined in paragraph 2 of this Article and the relevant mining and minerals law.</p> <p style="text-align: center;">Article 25 Types of explosions</p> <p>1. The types of explosions include:</p> <p>1.1. surface explosions, which can be:</p> <p>1.1.1. explosions in surface mines;</p> <p>1.1.2. explosions for construction purposes;</p> <p>1.1.3. explosions for rock crushing;</p> <p>1.1.4. explosions for deforestation purposes.</p> <p>1.2. underground explosions, which includes all underground explosion activities for the purpose of mineral resources exploitation;</p> <p>1.3. special explosions, which includes:</p> <p>1.3.1. underwater explosions;</p>	<p>kriterijumima utvrđenim u stavu 2. ovog člana i odgovarajućim zakonom o rudama i mineralima.</p> <p style="text-align: center;">Član 25 Vrste eksplozija</p> <p>1. Vrste eksplozija su:</p> <p>1.1. površinska eksplozija, koja može biti:</p> <p>1.1.1. eksplozija u površinskim rudnicima;</p> <p>1.1.2. eksplozija za građevinske svrhe;</p> <p>1.1.3. eksplozija za drobljenje stena;</p> <p>1.1.4. eksplozija za svrhe krčenja šuma.</p> <p>1.2. podzemna eksplozija, koja uključuje sve aktivnosti podzemne eksplozije koje imaju za cilj korišćenje mineralnih resursa.</p> <p>1.3. posebna eksplozija, koja uključuje:</p> <p>1.3.1. podvodnu eksploziju;</p>
--	--	--

<p>1.3.2. shpërthimin i ndërtesave të ndryshme;</p> <p>1.3.3. shpërthimin kërkimor sizmik;</p> <p>1.3.4. shpërthimin për qëllime teknologjike;</p> <p>1.3.5. shpërthimin e sipërfaqeve të akullit në lumenj dhe liqene;</p> <p>1.3.6. shpërthimin gjatë ndërtimit të tuneleve dhe objekteve të tjera nëntokësore, me përjashtim të shpërthimeve nëntokësore.</p> <p>1.4. shpërthimi i çminimit që përfshin të gjitha shpërthimet që kryhen në kuadër të aktiviteteve të çminimit.</p>	<p>1.3.2. explosions in different buildings;</p> <p>1.3.3. seismic research explosions;</p> <p>1.3.4. explosions for technological purposes;</p> <p>1.3.5. explosions on ice surfaces in rivers and lakes;</p> <p>1.3.6. explosions during the construction of tunnels and other underground facilities, excluding underground explosions.</p> <p>1.4. demining explosions, which include all explosions conducted as part of demining activities.</p>	<p>1.3.2. eksploziju raznih zgrada;</p> <p>1.3.3. eksploziju seizmičkog istraživanja;</p> <p>1.3.4. eksploziju za tehnološke svrhe;</p> <p>1.3.5. eksploziju ledenih površina u rekama i jezerima;</p> <p>1.3.6. eksploziju tokom izgradnje tunela i drugih podzemnih objekata, izuzev podzemnih eksplozija.</p> <p>1.4. deminerska eksplozija koja uključuje sve eksplozije koje se obavljaju u okviru aktivnosti deminiranja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 26 Detyrimet e operatorit për shpërthim</p>	<p style="text-align: center;">Article 26 Obligations of the explosives operator</p>	<p style="text-align: center;">Član 26 Obaveze operatera za eksploziju</p>
<p>1.1. procedurën e kontrollit të BE-së bazuar në lloj, sipas zgjedhjes së operatorit ekonomik:</p> <p>1.1.1. kontrollin e brendshëm të produktit, si edhe kontrollet shtesë të mbikëqyrjes në intervale rastësore;</p> <p>1.1.2. sigurinë e cilësisë së procesit të prodhimit;</p> <p>1.1.3. sigurinë e cilësisë së produktit.</p> <p>1.2. procedurën për verifikimin i njësisë së produktit;</p> <p>1.3. procedurën për sigurinë e plotë e cilësisë për fishekzjarrët e kategorisë F4.</p> <p>2. Procedura për vlerësimin e përputhshmërisë përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri i MPB-së.</p> <p style="text-align: center;">Neni 39 Vlerësimi i përputhshmërisë</p> <p>1. Vlerësimi i përputhshmërisë së artikujve piroteknikë bëhet nga vetë prodhuesi nëpërmjet organit evropian të vlerësimit të përputhshmërisë, kompetent për kryerjen e detyrave specifike të vlerësimit të</p>	<p>1.1. the EU-type examination procedure, according to the choice of the economic operator:</p> <p>1.1.1. internal product control, and additional supervised controls at random intervals;</p> <p>1.1.2. quality assurance of the production process;</p> <p>1.1.3. product quality assurance.</p> <p>1.2. product unit verification procedure;</p> <p>1.3. full quality assurance procedure for F4 category fireworks.</p> <p>2. The conformity assessment procedure is determined by a sub-legal act issued by the Minister of MIA.</p> <p style="text-align: center;">Article 39 Confirmity assessment</p> <p>1. The conformity assessment of pyrotechnic articles shall be carried out by the manufacturer through the European conformity assessment body, competent for carrying out specific tasks of conformity</p>	<p>1.1. postupak kontrole EU-a na osnovu vrste, prema izboru ekonomskog operatera:</p> <p>1.1.1. unutrašnju kontrolu proizvoda, kao i dodatne kontrole nadzora u nasumičnim intervalima;</p> <p>1.1.2. bezbednost kvaliteta proizvodnog procesa;</p> <p>1.1.3. bezbednost kvaliteta proizvoda.</p> <p>1.2. postupak za verifikaciju jedinice proizvoda;</p> <p>1.3. postupak za potpunu bezbednost kvaliteta vatrometa F4 kategorije.</p> <p>2. Postupak za procenu usklađenosti utvrđuje se podzakonskim aktom donetim od Ministra MUP-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 39 Procena usklađenosti</p> <p>1. Procena usklađenosti pirotehničkih sredstava se vrši od samog proizvođača preko Evropskog organa za procenjivanje usklađenosti, nadležnog za obavljanje specifičnih dužnosti procenjivanja</p>
--	---	---

<p>përputhshmërisë së produktit për vendosjen e shenjës CE.</p> <p>2. Kur një organ evropian i vlerësimit tregon përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në standardet e harmonizuara, vërteton që artikulli piroteknik përmbush të gjitha standardet e sigurisë për t'u hedhur në treg.</p> <p style="text-align: center;">Neni 40 Deklarata e përputhshmërisë</p> <p>1. Deklarata e përputhshmërisë e hartuar nga operatori ekonomik për lëndët plasëse duhet të përmbajë kriteret thelbësore të sigurisë dhe sipas formatit të përcaktuar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri i MPB-së.</p> <p>2. Operatori ekonomik me nënshkrimin e deklaratës së përputhshmërisë merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit sipas dispozitave të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 41 Rregullat dhe kushtet për vendosjen e shenjimit CE dhe shënjimet e tjera</p> <p>1. Shënja CE duhet të vendoset në mënyrë të dukshme tek artikulli piroteknik, të jetë e lexueshme dhe e pashlyeshme.</p>	<p>assessment of the product for affixing the CE markings.</p> <p>2. When a European assessment body shows compliance with the criteria outlined in the harmonized standards, it must certify that the pyrotechnic articles comply with all safety standards required to make them available on the market.</p> <p style="text-align: center;">Article 40 Declaration of conformity</p> <p>1. The declaration of conformity for explosives prepared by the economic operator must include essential safety criteria and adhere to the format determined in the sub-legal act issued by the Minister of the MIA.</p> <p>2. Upon signing the declaration of conformity, the economic operator takes on the responsibility for ensuring the product conformity in accordance with the provisions of this law.</p> <p style="text-align: center;">Article 41 Rules and conditions for affixing the CE marking and other markings</p> <p>1. The CE marking shall be affixed visibly, legibly and indelibly to the pyrotechnic article.</p>	<p>usklađenosti proizvoda za stavljanje CE oznake.</p> <p>2. Kada evropski organ za procenjivanje pokaže usklađenost sa kriterijumima utvrđenim u usklađenim standardima, potvrđuje da pirotehničko sredstvo ispunjava sve bezbednosne standarde za stavljanje na tržište.</p> <p style="text-align: center;">Član 40 Izjava o usklađenosti</p> <p>1. Izjava o usklađenosti izrađena od ekonomskog operatera za eksplozivne materije mora sadržati suštinske kriterijume bezbednosti i prema formatu utvrđenim podzakonskim aktom donesenim od Ministra MUP-a.</p> <p>2. Ekonomski operater potpisivanjem izjave o usklađenosti, preuzima odgovornost za usklađenost proizvoda prema odredbama ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 41 Pravila i uslovi za stavljanje CE oznake i drugih oznaka</p> <p>1. CE oznaka mora se staviti na vidljiv način na pirotehničko sredstvo, biti čitljiva i neizbrisiva.</p>
---	---	---

<p>2. Kur kjo është e pamundur, shënja vendoset në ambalazh dhe në dokumentet shoqëruese.</p> <p>3. Shënja CE duhet të fiksohet përpara se artikulli piroteknik të vendoset në treg.</p> <p>4. Shënja CE shoqërohet nga një numër identifikimi i organit të evropian të vlerësimit të përputhshmërisë, i cili është përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit.</p> <p>5. Numri i identifikimit vendoset nga vetë organi ose, sipas udhëzimeve të tij, nga ana e prodhuesit ose përfaqësuesit të autorizuar të këtij të fundit.</p> <p>6. Shënja CE dhe numri identifikues i organit evropian të vlerësimit të përputhshmërisë, kur është e mundur, shoqërohet edhe nga një shenjë tjetër që tregon rrezik ose përdorim të veçantë.</p> <p>7. Për zbatimin e këtij neni Ministri nxjerr akt nënligjor.</p>	<p>2. Where that is not possible, it shall be affixed to the packaging and to the accompanying documents.</p> <p>3. The CE marking shall be affixed before the pyrotechnic article is placed on the market.</p> <p>4. The CE marking shall be followed by an identification number of the European conformity assessment body that is involved in the production control phase.</p> <p>5. The identification number shall be affixed by the body itself or, under its instructions, by the manufacturer or his authorized representative.</p> <p>6. The CE marking and, where applicable, the identification number of the European conformity assessment body may be followed by any other mark indicating a special risk or use.</p> <p>7. For the implementation of this Article, the Minister shall issue a sub-legal act.</p>	<p>2. Kada je to nemoguće, oznaka se stavlja na ambalaži i prateće dokumente.</p> <p>3. CE oznaka mora se fiksirati pre nego što se pirotehničko sredstvo stavi na tržište.</p> <p>4. CE oznaka se prati od identifikacionog broja Evropskog organa za procenu usklađenosti, koji je uključen u fazi kontrole proizvodnje.</p> <p>5. Identifikacioni broj se stavlja od samog organa ili, prema njegovim uputstvima, od strane proizvođača ili njegovog ovlašćenog zastupnika.</p> <p>6. CE oznaka i identifikacioni broj Evropskog organa za procenu usklađenosti, kada je moguće, praćen i drugim oznakom koja ukazuje opasnost ili posebnu upotrebu.</p> <p>7. Za sprovođenje ovog člana Ministar donosi podzakonski akt.</p>
--	--	--

<p align="center">Neni 42</p> <p>Leja për testimin e artikujve piroteknikë</p>	<p align="center">Article 42</p> <p>Permit for testing pyrotechnic articles</p>	<p align="center">Član 42</p> <p>Dozvola za testiranje pirotehničkih sredstava</p>
<p>1. Operatori ekonomik ose prodhuesi mund të kryejë teste të artikujve piroteknikë për nevojat e tyre profesionale në procedurën e vlerësimit të përputhshmërisë pasi të ketë marrë lejen për testim.</p> <p>2. Leja nga paragrafi 1 i këtij neni i lëshohet operatorit ekonomik pasi t'i ketë plotësuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta si në vijim:</p> <p>2.1. të ketë të angazhuar persona të kualifikuar që do të trajtojnë lëndët plasëse gjatë testimit;</p> <p>2.2. të ketë të lejen e posedimit apo të përdorimit të laboratorit për testim të artikujve piroteknikë;</p> <p>2.3. të ketë pronësinë, apo të drejtën për të përdorur hapësirën ose objektin për testimin e artikujve piroteknikë në vendin ku kryhet testimi;</p> <p>2.4. të ketë pronësinë, ose të drejtën për të përdorur magazinën për qëllime të përcaktuara;</p>	<p>1. The economic operator or manufacturer may conduct testing of pyrotechnic articles for their professional needs in the conformity assessment procedure after obtaining a testing permit.</p> <p>2. The permit from paragraph 1 of this Article shall be granted to the economic operator once they have met the general and specific criteria outlined below:</p> <p>2.1. employ qualified individuals to handle explosives during testing;</p> <p>2.2. have permission to possess or use the laboratory for testing pyrotechnic articles;</p> <p>2.3. have the ownership, or the right to use the space or facility for testing pyrotechnic articles in the location where the testing is conducted;</p> <p>2.4. have the ownership, or the right to use the warehouse for specified purposes;</p>	<p>1. Ekonomski operater ili proizvođač može izvršiti testiranja pirotehničkih sredstava za svoje stručne potrebe u postupku procene usklađenosti nakon što bude dobio dozvolu za testiranje.</p> <p>2. Dozvola iz stava 1. ovog člana izdaje se ekonomskom operateru nakon što bude ispunio opšte kriterijume i posebne kriterijume kao u nastavku:</p> <p>2.1. da ima angažovana kvalifikovana lica koje će tretirati eksplozivne materije tokom testiranja;</p> <p>2.2. da ima dozvolu za posedovanje ili korišćenje laboratorije za testiranje pirotehničkih sredstava;</p> <p>2.3. da ima vlasništvo, ili pravo korišćenja prostora ili objekta za testiranje pirotehničkih sredstava u mestu gde se obavlja testiranje;</p> <p>2.4. da ima vlasništvo, ili pravo korišćenja skladišta za utvrđene svrhe;</p>

<p>2.5. të ketë leje të magazinimit, ose dëshmi të posedimit të një magazine të përkohshme të ndërtuar brenda laboratorit të testimit.</p> <p>3. Operatori ekonomik që kryen testimin e artikujve piroteknikë duhet të njoftojë MPB-në për marrjen e mostrave të artikujve piroteknikë për qëllime të testimit jo më vonë se shtatëdhjetë (72) orë para testimit.</p> <p>4. Nëse një operator ekonomik ka lejen për prodhim të artikujve piroteknikë, mund të kryejë teste të artikujve piroteknikë me qëllim të kontrollit të prodhimit të tij pa leje për testim.</p> <p style="text-align: center;">Neni 43 Leja për prodhim të artikujve piroteknikë</p> <p>1. Operatori ekonomik mund të fillojë prodhimin e artikujve piroteknikë, pasi të jetë pajisur me leje për prodhim të artikujve piroteknikë.</p> <p>2. Leja nga paragrafi 1 i këtij neni i lëshohet operatorit ekonomik pasi t'i ketë plotësuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta si në vijim:</p>	<p>2.5. have a storage permit, or evidence of possession of a temporary warehouse built within the testing laboratory.</p> <p>3. The economic operator conducting testing of pyrotechnic must notify the MIA about taking samples of the pyrotechnic articles for testing purposes at least seventy-two (72) hours before the testing.</p> <p>4. If an economic operator holds a permit for producing pyrotechnic articles, they are allowed to conduct pyrotechnic articles testing to control their production without obtaining a testing permit.</p> <p style="text-align: center;">Article 43 Permit for production of pyrotechnic articles</p> <p>1. The economic operator may begin producing pyrotechnic articles after having obtained the permit for the production of pyrotechnic articles.</p> <p>2. The permit from paragraph 1 of this Article shall be granted to the economic operator once they have met the general and specific criteria outlined below:</p>	<p>2.5. da ima dozvolu za skladištenje, ili dokaz o posedovanju privremenog skladišta izgrađenog unutar laboratorije za testiranje.</p> <p>3. Ekonomski operater koji obavlja testiranje pirotehničkih sredstava mora obavestiti MUP-a za uzimanje uzoraka pirotehničkih sredstava za svrhe testiranja ne kasnije od sedamdeset dva (72) sata pre testiranja.</p> <p>4. Ako ekonomski operater ima dozvolu za proizvodnju pirotehničkih sredstava, može obaviti testiranja pirotehničkih sredstava u cilju kontrole njihove proizvodnje bez dozvole za testiranje.</p> <p style="text-align: center;">Član 43 Dozvola za proizvodnju pirotehničkih sredstava</p> <p>1. Ekonomski operater može započeti proizvodnju pirotehničkih sredstava nakon što bude opremljen dozvolom za proizvodnju pirotehničkih sredstava.</p> <p>2. Dozvola iz stava 1. ovog člana izdaje se ekonomskom operateru nakon što bude ispunio opšte kriterijume i posebne kriterijume kao u nastavku:</p>
--	---	--

<p>2.1 të jetë i pajisur me lejen për magazinë të sigurtë;</p> <p>2.2 të ketë persona të autorizuar dhe të kualifikuar për prodhim;</p> <p>2.3 të paraqesë të dhënat për llojin e artikujve piroteknikë që planifikohen të prodhohen;</p> <p>2.4 të paraqesë të dhënat për procesin dhe teknologjinë e prodhimit;</p> <p>2.5 të jetë i pajisur me lejen e ndërtimit për objektet ku prodhohen artikujt piroteknikë;</p> <p>2.6 të ketë planin emergjent për vendin e prodhimit;</p> <p>2.7 të ketë planin e sigurisë së vendprodhimit;</p> <p>2.8 të ketë kryer vlerësimin e rrezikut;</p> <p>2.9 të ketë vlerësimin e ndikimit në mjedis.</p> <p>3. Leja për prodhimin e artikujve piroteknikë inspektohet rregullisht për përmbushjen e kritereve ligjore të përcaktuara me këtë ligj me qëllim që të sigurojë mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së</p>	<p>2.1. have a permit for safe storage;</p> <p>2.2. have authorized and qualified individuals for production;</p> <p>2.3. provide data on type of pyrotechnic articles planned to be produced;</p> <p>2.4. provide data on the technology and production process;</p> <p>2.5. have a construction permit for facilities where pyrotechnic articles are produced;</p> <p>2.6. have an emergency plan for the production site;</p> <p>2.7. have a site security plan;</p> <p>2.8. have a risk assessment;</p> <p>2.9. have an environmental impact assessment.</p> <p>3. The permit for the production of pyrotechnic articles must be regularly inspected to ensure compliance with the legal criteria defined by this Law in order to protect the lives and health of individuals, as</p>	<p>2.1. da bude opremljen dozvolom za bezbedno skladištenje;</p> <p>2.2. da ima ovlašćena i kvalifikovana lica za proizvodnju;</p> <p>2.3. da predstavi podatke o vrsti pirotehničkih sredstava koja se planiraju proizvoditi;</p> <p>2.4. da predstavi podatke o procesu i tehnologiji proizvodnje;</p> <p>2.5. da bude opremljen građevinskom dozvolom za objekte gde se proizvode pirotehnička sredstva;</p> <p>2.6. da ima plan za vanredne situacije za mesto proizvodnje;</p> <p>2.7. da ima bezbednosni plan proizvodnog mesta;</p> <p>2.8. da je obavio procenu opasnosti;</p> <p>2.9. da ima procenu uticaja na životnu sredinu.</p> <p>3. Dozvola za proizvodnju pirotehničkih sredstava redovno se pregledava za ispunjavanje zakonskih kriterijuma utvrđenih ovim zakonom u cilju</p>
---	---	---

<p>personave, si dhe mbrojtjen e pronës dhe mjedisit.</p> <p>4. MPB vendos brenda tridhjetë (30) ditëve në lidhje me kërkesën.</p> <p style="text-align: center;">Neni 44 Detyrimet e prodhuesve të artikujve piroteknikë</p> <p>1. Prodhuesit, kur hedhin në treg artikujt piroteknikë, sigurohen që ata të jenë projektuar dhe prodhuar në përputhje me kriteret kryesore të sigurisë.</p> <p>2. Prodhuesit hartojnë dokumentacionin teknik për artikujt piroteknikë të prodhuar dhe ndjekin procedurën e përshtatshme të vlerësimit të përputhshmërisë sipas nenit 38 të këtij ligji.</p> <p>3. Pasi të jetë ndjekur procedura e vlerësimit të përputhshmërisë sipas nenit 38 të këtij ligji, prodhuesi harton një deklaratë të përputhshmërisë dhe vendos shenjen CE.</p> <p>4. Prodhuesit e ruajnë dokumentacionin teknik dhe deklaratën e përputhshmërisë së BE-së për një periudhë dhjetë (10) vjeçare, pasi artikulli piroteknik vendoset në treg.</p>	<p>well as safeguard property and the environment.</p> <p>4. The MIA shall decide within thirty (30) days regarding the request.</p> <p style="text-align: center;">Article 44 Obligations of the manufacturers of pyrotechnic articles</p> <p>1. When placing their pyrotechnic articles on the market, manufacturers must ensure that they have been designed and manufactured in compliance with the essential safety requirement.</p> <p>2. Manufacturers shall create technical documentation for pyrotechnic articles they produce and adhere to the appropriate conformity assessment procedure as outlined in Article 38 of this Law.</p> <p>3. Following the conformity assessment procedure outlined in Article 38 of this Law, the manufacturer must then prepare a declaration of conformity and affix the CE marking.</p> <p>4. Manufacturers must retain the technical documentation and EU declaration of conformity for ten (10) years after the pyrotechnic article is placed on the market.</p>	<p>obezbeđivanja zaštite zdravlja i života lica, kao i zaštite imovine i životne sredine.</p> <p>4. MUP odlučuje u roku od trideset (30) dana u vezi sa zahtevom.</p> <p style="text-align: center;">Član 44 Obaveze proizvođača pirotehničkih sredstava</p> <p>1. Proizvođači kada stavljaju na tržište pirotehnička sredstva, obezbeđuju se da su projektovana i proizvedena u skladu sa glavnim kriterijima bezbednosti.</p> <p>2. Proizvođači izrađuju tehničku dokumentaciju za proizvedena pirotehnička sredstva i prate odgovarajući postupak procenjivanja usklađenosti prema članu 38. ovog zakona.</p> <p>3. Nakon što bude praćen postupak procenjivanja usklađenosti prema članu 38. ovog zakona, proizvođač izrađuje izjavu o usklađenosti i stavlja CE oznaku.</p> <p>4. Proizvođači čuvaju tehničku dokumentaciju i izjavu o usklađenosti EU-a u periodu od deset (10) godina, nakon što se pirotehničko sredstvo stavi na tržište.</p>
--	---	--

<p>5. Prodhuesit sigurohen që zbatimi i procedurave për prodhimin në seri të bëhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.</p> <p>6. Modifikimet në projektim ose ato të lidhura me karakteristikat e artikullit piroteknik, si dhe ndryshimet në standardet e harmonizuara apo ndryshimet e specifikimeve të tjera teknike duhet të reflektohen në dokumentacionin shoqërues të produktit.</p> <p>7. Prodhuesit, në varësi të rrezikut që paraqet një artikull piroteknik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë së konsumatorëve, në vijim të kërkesës së arsyetuar tek MPB dhe pas marrjes së miratimit përkatës, kryejnë testimin e mostrës së artikujve piroteknikë që janë vendosur në treg.</p> <p>8. Për artikujt e vendosur në treg prodhuesit hetojnë dhe mbajnë një regjistër të ankesave, ku regjistrojnë gjithashtu edhe artikujt piroteknikë që nuk plotësojnë kriteret e sigurisë, si dhe rastet e kthimit të artikujve piroteknikë. Prodhuesit janë të detyruar të informojnë shpërndarësit me përmbajtjen e regjistrit.</p>	<p>5. Manufacturers must make sure that the procedures for series production are conducted in compliance with the provisions of this law.</p> <p>6. Any alternations to the design or characteristics of the pyrotechnic article, as well as changes to harmonized standards or other technical specifications must be documented in the accompanying product documentation.</p> <p>7. When it is deemed appropriate due to the risks associated with pyrotechnic article, upon a duly justified request of the MIA and after receiving the relevant approval, manufacturers, in order to protect the health and safety of consumers, they must perform sample testing of pyrotechnic articles, that have been placed on the market.</p> <p>8. For articles placed on the market, manufacturers must investigate and maintain a register of complaints, where they also record pyrotechnic articles that do not meet safety criteria, as well as cases of recalls of pyrotechnic articles. Manufacturers are required to inform distributors of the contents of the register.</p>	<p>5. Proizvođači obezbeđuju se da se sprovođenje postupaka za serijsku proizvodnju vrši u skladu sa odredbama ovog zakona.</p> <p>6. Modifikacije u projektovanju ili one vezane sa karakteristikama pirotehničkog sredstva, kao i izmene u usklađenim standardima ili izmene drugih tehničkih specifikacija moraju se odraziti u pratećoj dokumentaciji proizvoda.</p> <p>7. Proizvođači, u zavisnosti od opasnosti koju predstavlja pirotehničko sredstvo, u cilju zaštite zdravlja i bezbednosti potrošača, u nastavku obrazloženog zahteva MUP-a i nakon dobijanja odgovarajućeg usvajanja, obavljaju testiranje uzoraka pirotehničkih sredstava koja su stavljena na tržište.</p> <p>8. Za sredstva stavljena na tržište proizvođači istražuju i vode registar žalbi gde registruju takođe i pirotehnička sredstva koja ne ispunjavaju kriterijume bezbednosti, kao i slučajevi vraćanja pirotehničkih sredstava. Proizvođači su dužni da informišu distributere o sadržaju registra.</p>
--	---	---

<p>9. Prodhuesit sigurohen që artikujt piroteknikë të vendosur në treg të etiketohen sipas neneve 36 dhe 37 të këtij ligji.</p> <p>10. Prodhuesit tek çdo artikull piroteknik vendosin:</p> <p>10.1. emrin e tyre;</p> <p>10.2. emrin e regjistruar tregtar ose markën e regjistruar tregtare;</p> <p>10.3. adresën postare.</p> <p>11. Në rast se vendosja e të dhënave sipas paragrafit 10 të këtij neni është e pamundur, këto të dhëna vendosen te paketimi i tij ose te një dokument shoqërues i artikullit piroteknikë.</p> <p>12. Adresa tregon një vendndodhje të vetme ku mund të kontaktohet prodhuesi;</p> <p>13. Të dhënat duhet të jenë në gjuhë zyrtare.</p> <p>14. Prodhuesit sigurohen që artikulli piroteknik të shoqërohet nga të dhënat për mënyrën e përdorimit, të mirëmbajtjes dhe rreziqet që lidhen me përdorimin e tyre, në gjuhët zyrtare. Të dhënat për mënyrën e përdorimit, të mirëmbajtjes dhe rreziqet që</p>	<p>9. Manufacturers must ensure that pyrotechnic articles placed on the market are labeled according to Articles 36 and 37 of this Law.</p> <p>10. Manufacturers must indicate on each pyrotechnic article:</p> <p>10.1. their name;</p> <p>10.2. registered trade name or trade mark;</p> <p>10.3. postal address.</p> <p>11. If it is not possible to place the data according to paragraph 10 of this Article, this information (data) should be placed on the packaging or on an accompanying document of the pyrotechnic article.</p> <p>12. The address shall indicate a single point of contact for the manufacturer;</p> <p>13. The information must be in the official language.</p> <p>14. Manufacturers shall ensure that the pyrotechnic article is accompanied by instructions on how to use, maintain and the risks associated with their use, in official language. Information on how to use, maintain and the risks associated with their</p>	<p>9. Proizvođači se obezbeđuju da se pirotehnička sredstva stavljena na tržište etiketiraju prema članovima 36. i 37. ovog zakona.</p> <p>10. Proizvođači na svaki pirotehnički proizvod stavljaju:</p> <p>10.1. njihovo ime;</p> <p>10.2. registrovano trgovinsko ime ili registrovanu trgovinsku marku;</p> <p>10.3. poštansku adresu.</p> <p>11. U slučaju da je postavljanje podataka prema stavu 10. ovog člana nemoguće, ovi podaci se stavljaju na njegovo pakovanje ili na prateći dokument pirotehničkog sredstva.</p> <p>12. Adresa pokazuje jednu lokaciju gde se proizvođač može kontaktirati;</p> <p>13. Podaci moraju biti na službenom jeziku.</p> <p>14. Proizvođači se obezbeđuju da pirotehničko sredstvo bude proračeno podacima o načinu upotrebe, održavanju i opasnostima koje se vežu sa njegovom upotrebom, na službenim jezicima. Podaci o načinu upotrebe, održavanju i opasnostima</p>
--	--	--

<p>lidhen me përdorimin e tyre, si edhe etiketimi duhet të jenë të kuptueshme dhe të qarta.</p> <p>15. Prodhuesit që konsiderojnë se artikulli piroteknik, të cilin ata e kanë vendosur në treg nuk është në përputhje me këtë ligj, marrin menjëherë masat e domosdoshme për rregullimin e mospërputhshmërisë dhe nëse është e nevojshme, e kthejnë ose tërheqin artikullin nga tregu.</p> <p>16. Në rast se ky artikull piroteknik paraqet rrezik, prodhuesit informojnë autoritetet kompetente të mbikëqyrjes së tregut duke dhënë hollësi, sidomos për mospërmbushjen e kriterëve dhe për masat korrektuese të ndërmarra.</p> <p>17. Në rast të një kërkesës nga MPB, prodhuesi duhet të ofrojë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin në formë shkresore ose elektronike që nevojitet për të demonstruar përputhshmërinë e artikullit piroteknik me dispozitat e këtij ligji.</p> <p>18. Prodhuesit duhet të bashkëpunojnë me strukturat e mbikëqyrjes së tregut për çdo veprim të ndërmarrë për eliminimin e rreziqeve që paraqitet nga artikujt piroteknikë që cilët kanë vendosur në treg.</p>	<p>use, as well as labeling, should be understandable and clear.</p> <p>15. Manufacturers who consider that a pyrotechnic article which they have placed on the market is not in conformity with this Law shall immediately take the corrective measures necessary to bring that pyrotechnic article into conformity and, if appropriate, to withdraw it or recall it.</p> <p>16. Where the pyrotechnic article presents a risk, manufacturers shall immediately inform the competent supervision authorities, giving details, in particular, of the non-compliance and of any corrective measures taken.</p> <p>17. Manufacturers, following a request from the MIA, shall provide all the information and documentation in written or electronic form that is required to demonstrate the conformity of the pyrotechnic article with the provisions of this Law.</p> <p>18. Manufacturers shall cooperate with the market surveillance structures for any action taken to eliminate the risks posed by the pyrotechnic articles they have made available on the market.</p>	<p>koje se vežu sa njihovom upotrebom, kao i etiketiranje moraju biti razumljivi i jasni.</p> <p>15. Proizvođači koji smatraju da pirotehničko sredstvo, koje su stavili na tržište nije u skladu sa ovim zakonom, odmah preduzimaju neophodne mere za regulisanje neusklađenosti i ako je potrebno vraćaju ili povlače sredstvo sa tržišta.</p> <p>16. U slučaju da ovo pirotehničko sredstvo predstavlja opasnost, proizvođači informišu nadležne autoritete za nadzor tržišta dajući detalje, posebno o neispunjavanju kriterijuma i za preduzetim korektivnim merama.</p> <p>17. U slučaju zahteva od MUP-a, proizvođač mora pružiti sve informacije i dokumentaciju u pisanom ili elektronskom obliku koja je potrebna za dokazivanje usklađenosti pirotehničkog sredstva sa odredbama ovog zakona.</p> <p>18. Proizvođači moraju sarađivati sa strukturama za nadzor nad tržištem za svaku radnju preduzetu za otklanjanje opasnosti koje se pojave od pirotehnička sredstva koja su stavili na tržište.</p>
---	---	--

<p>19. Në fazën e projektimit të repartit për prodhimin e artikujve piroteknikë prodhuesit duhet t'i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis si dhe të sigurojnë lejet përkatëse mjedisore për prodhimin e artikullit piroteknik përpara vënies në punë, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe të atij për lejet e mjedisit. Modifikimet në projektim ose në instalimet e prodhimit, që janë të lidhura me karakteristikat/standardet e harmonizuara të artikullit piroteknikë apo ndryshimet në specifikimet teknike, duhet të jenë pjesë e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe lejes përkatëse të mjedisit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 45 Leja për kërkim dhe hulumtim të artikujve piroteknikë</p> <p>1. Prodhuesit e artikujve piroteknikë si dhe institucionet shkencore mund të bëjnë kërkim dhe hulumtim të artikujve piroteknikë pasi të jenë pajisur me leje për kërkim dhe hulumtim të artikujve piroteknikë.</p> <p>2. Leja nga paragrafi 1 i këtij neni i lëshohet operatorit ekonomik pasi t'i ketë plotësuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta si në vijim:</p>	<p>19. At the design stage of the department responsible for production of pyrotechnic articles, manufacturers must undergo the Environmental Impact Assessment procedure, and obtain the necessary environmental permits for the production of the pyrotechnic articles before starting production, in accordance with the requirements of the legislation in force for environmental impact assessment and environmental permits. Any changes to the design or production installations, that are related to the harmonized characteristics / standards of the pyrotechnic article or any changes in the technical specifications, must be part of the Environmental Impact Assessment and the relevant environmental permit.</p> <p style="text-align: center;">Article 45 Permit for searching and researching pyrotechnic articles</p> <p>1. Producers of pyrotechnic articles, as well as scientific institutions, may carry out research on pyrotechnic articles after obtaining a permit for searching and researching pyrotechnic articles.</p> <p>2. The permit from paragraph 1 of this Article shall be granted to the economic operator once they have met the general and specific criteria outlined below:</p>	<p>19. U fazi projektovanja odeljenja za proizvodnju pirotehničkih sredstava, proizvođači moraju podležti postupku procene uticaja na životnu sredinu kao i obezbediti odgovarajuće dozvole životne sredine za proizvodnju pirotehničkog sredstva pre puštanja u rad, u skladu sa zahtevima zakonodavstva na snazi za procenu uticaja na životnu sredinu i onoga o dozvolama životne sredine. Modifikacije u projektovanju ili instalacijama proizvodnje, koja su vezana sa usklađenim karakteristikama/standardima pirotehničkog sredstva ili izmene u tehničkim specifikacijama, moraju biti deo procene uticaja na životnu sredinu i odgovarajuće dozvole o životnoj sredini.</p> <p style="text-align: center;">Član 45 Dozvola za pretragu i istraživanje pirotehničkih sredstava</p> <p>1. Proizvođači pirotehničkih sredstava, kao i naučne institucije mogu obavljati pretrage i istraživanja pirotehničkih sredstava nakon što budu opremljeni dozvolom za pretragu i istraživanje pirotehničkih sredstava.</p> <p>2. Dozvola iz stava 1. ovog člana izdaje se ekonomskom operateru nakon što bude ispunio opšte kriterijume i posebne kriterijume kao u nastavku::</p>
---	---	--

<p>2.1. operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrin shtetëror, ose personi përgjegjës duhet të bëjë pjesë në institucionin shkencor që ka veprimtarinë e regjistruar për të cilën është kërkuar leja;</p> <p>2.2. personi përgjegjës duhet të ketë të përfunduar shkollim universitar në fushën e shkencave të natyrës apo teknike;</p> <p>2.3. të ketë të drejtën e shfrytëzimit të objektit në të cilin do të kryhet kërkimi dhe hulumtim i artikujve piroteknikë;</p> <p>2.4. të jetë i pajisur me leje përdorimi për objektin në të cilin do të bëhet magazinimi i artikujve piroteknikë;</p> <p>2.5. të jetë i pajisur me lejen e përdorimit për objektin në të cilin ndodhet magazinimi i përkohshëm;</p> <p>2.6. të ketë raportin teknologjik mbi procedurën e kërkimit dhe hulumtimit;</p> <p>2.7. të plotësojnë kriteret nga neni 11, paragrafët 1, 2, 3 dhe 6 të këtij ligji;</p>	<p>2.1. the economic operator must be registered in the state register, or the responsible person must be part of a scientific institution with a registered activity for which the permit is being requested;</p> <p>2.2. the responsible person must hold a university education in the field of natural or technical sciences;</p> <p>2.3. must have the right to use the facility where the searching and researching of pyrotechnic articles will take place;</p> <p>2.4. must have a permit for using the facility in which pyrotechnic articles will be stored;</p> <p>2.5. must have a permit for using the facility in which the temporary storage is located;</p> <p>2.6. must have a technological report outlining searching and researching procedures;</p> <p>2.7. must meet the criteria outlined in Article 11, paragraphs 1, 2, 3, and 6 of this Law;</p>	<p>2.1. ekonomski operater mora biti registrovan u državnom registru, ili odgovorno lice mora biti deo u naučnoj instituciji koja ima registrovanu delatnost za koju je zahtevana dozvola;</p> <p>2.2. odgovorno lice mora imati završeno univerzitetsko školovanje u oblasti prirodnih ili tehničkih nauka;</p> <p>2.3. da ima pravo korišćenja objekta u kojem će se obavljati pretraga i istraživanje pirotehničkih sredstava;</p> <p>2.4. da bude opremljen upotrebnom dozvolom za objekat u kojem će se vršiti skladištenje pirotehničkih sredstava;</p> <p>2.5. da bude opremljen upotrebnom dozvolom za objekat u kojem se dešava privremeno skladištenje;</p> <p>2.6. da ima tehnološki izveštaj o postupku pretrage i istraživanja;</p> <p>2.7. da ispunjavaju kriterijume iz člana 11., stavovi 1,2,3 i 6. ovog zakona;</p>
--	--	---

<p>2.8. të kenë sistem të vetin të kontrollit të cilësisë.</p> <p>3. Prodhuesit e artikujve piroteknikë, të cilët kanë leje të vlefshme prodhuese nuk kanë nevojë të përmbushin kriteret nga paragrafi 2, nënparagrafi nga paragrafi 2.8. i këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 46 Leja për import, eksport, transit dhe transferim të artikujve piroteknikë</p> <p>1. Operatori ekonomik mund të fillojë aktivitetin e importit, eksportit, transitit dhe transferimit të artikujve piroteknik vetëm pasi të jetë pajisur me leje për import, eksport, transit dhe transferim të artikujve piroteknik nga ministria.</p> <p>2. Përveç kriterëve të përgjithshme, duhet të plotësohen edhe kriteret e veçanta si në vijim:</p> <p>2.1. të ketë lejen e importit ose transitit të vendit në të cilin artikujt piroteknikë janë duke u eksportuar ose përmes së cilit është duke u bërë transiti i tyre;</p> <p>2.2. të ketë certifikatën e përdoruesit të fundit;</p>	<p>2.8. must have their own quality control system.</p> <p>3. Manufacturers of pyrotechnic articles with a valid manufacturing permit do not need to meet the criteria outlined in paragraph 2, subparagraph 2.8. of this Article.</p> <p style="text-align: center;">Article 46 Permit for import, export, transit and transfer of pyrotechnic articles</p> <p>1. The economic operator may start the activity of import, export, transit, and transfer of pyrotechnic articles after having obtained from the Ministry a permit for import, export, transit and transfer of pyrotechnic articles.</p> <p>2. In addition to the general criteria, the economic operator must meet the following specific requirements:</p> <p>2.1. have the import or transit permit of the country to which the pyrotechnic articles are being exported or through which their transit is being done;</p> <p>2.2. have the end-user certificate;</p>	<p>2.8. da imaju sopstveni sistem kontrole kvaliteta.</p> <p>3. Proizvođači pirotehničkih sredstava, koji imaju važeću proizvodnju dozvolu, nemaju potrebe ispunjavati kriterijume iz stava 2. podstav od stava 2.8. ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 46 Dozvola za uvoz, izvoz, tranzit i prenos pirotehničkih sredstava</p> <p>1. Ekonomski operater može započeti aktivnost uvoza, izvoza, tranzita i prenosa pirotehničkih sredstava samo nakon što bude opremljen dozvolom za uvoz, izvoz, tranzit i prenos pirotehničkih sredstava od ministarstva.</p> <p>2. Pored opštih kriterijuma, moraju se ispuniti i posebni kriterijumi kao u nastavku:</p> <p>2.1. da ima uvoznou ili tranzitnu dozvolu zemlje u koju se pirotehnička sredstva izvoze ili kroz koju se vrši njihov tranzit;</p> <p>2.2. da ima sertifikat krajnjeg korisnika;</p>
--	--	--

<p>2.3.të këtë licencën për transport rrugor për mallra të rrezikshme të lëshuar nga ministria përkatëse e mjedisit;</p> <p>2.4.të këtë leje për magazinim të artikujve piroteknikë.</p> <p>3. Operatori ekonomik bashkë me kërkesën duhet të ofrojë edhe informatat si në vijim:</p> <p>3.1.emrin e artikujve piroteknikë dhe numrin identifikues të KB-së;</p> <p>3.2.emrin dhe adresën e prodhuesit;</p> <p>3.3.emrin dhe adresën e shitësit ose dërguesit të artikujve piroteknikë;</p> <p>3.4. emrin dhe adresën e blerësit ose pranuesit të artikujve piroteknikë;</p> <p>3.5.emrin dhe adresën e vozitësit të automjetit, tipin e automjetit dhe numrin e targave të automjetit;</p> <p>3.6.sasinë e artikujve piroteknikë;</p> <p>3.7.tabelën e të dhënave të sigurisë;</p> <p>3.8.informatat identifikuese të artikujve piroteknikë;</p>	<p>2.3. have the license for road transport of hazardous goods issued by the relevant Ministry;</p> <p>2.4. have a permit for the storage of pyrotechnic articles.</p> <p>3. Along with the request, the economic operator must provide the following information:</p> <p>3.1. name of the pyrotechnic articles and the UN identification number;</p> <p>3.2. name and address of the manufacturer;</p> <p>3.3. name and address of the seller or consignor of the pyrotechnic articles;</p> <p>3.4. name and address of the purchaser or receiver of the pyrotechnic articles;</p> <p>3.5. name and address of the driver of the vehicle, type of vehicle and the vehicle's plate number;</p> <p>3.6. quantity of pyrotechnic articles;</p> <p>3.7. safety data sheet;</p> <p>3.8. pyrotechnic articles identification information;</p>	<p>2.3. da ima licencu za drumski prevoz opasnih roba izdatu od odgovarajućeg ministarstva životne sredine;</p> <p>2.4. da ima dozvolu za skladištenje pirotehničkih sredstava.</p> <p>3. Ekonomski operater zajedno sa zahtevom, mora da pruži i informacije kao u nastavku:</p> <p>3.1. ime pirotehničkih sredstava i identifikacioni broj UN-a;</p> <p>3.2. ime i adresu proizvođača;</p> <p>3.3. ime i adresu prodavca ili dostavljača pirotehničkih sredstava;</p> <p>3.4. ime i adresu kupca ili primaoca pirotehničkih sredstava;</p> <p>3.5. ime i adresu vozača vozila, tip vozila i broj registarskih tablica vozila;</p> <p>3.6. količinu pirotehničkih sredstava;</p> <p>3.7. tabelu bezbednosnih podataka;</p> <p>3.8. identifikacione informacije pirotehničkih sredstava;</p>
---	--	--

<p>3.9. datën dhe kohën e importit, eksportit, transitit dhe transferimit;</p> <p>3.10. kohën dhe vendin e ndalesave të parashikuara;</p> <p>3.11. hyrjen dhe daljen në kalimin kufitar dhe formën e transportit nëse është e aplikueshme;</p> <p>3.12. qëllimin e transferimit, nëse është e mundshme.</p> <p>4. Leja për eksport, transit dhe transferim vlen në afatin kohor prej tridhjetë (30) ditësh.</p> <p>5. Leja për import, vlen në afatin kohor prej nëntëdhjetë (90) ditësh.</p> <p>6. MPB përcakton masat e veçanta të sigurisë për import, eksport apo kalim transit nëpër territorin e Republikës së Kosovës.</p> <p>7. Në rast të rrezikimit të sigurisë publike dhe për të parandaluar posedimin dhe përdorimin ilegal të artikujve piroteknikë, MPB mund të kufizojë ose të ndalojë importin, eksportin, transitin ose transferimin e tyre, në tërë territorin, ose në një pjesë të territorit të Kosovës.</p>	<p>3.9. date and time of import, export, transit and transfer;</p> <p>3.10. time and place of anticipated stops;</p> <p>3.11. entry and exit at the border crossing and mode of transport if applicable;</p> <p>3.12. purpose of transfer; if applicable.</p> <p>4. The export, transit or transfer permit is valid for a period of thirty (30) days.</p> <p>5. The import permit is valid for a period of ninety (90) days.</p> <p>6. The MIA shall determine special security measures for import, export or transit through the territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>7. In case of endangering public safety and in order to prevent illegal possession and use of pyrotechnic articles, the MIA may restrict or prohibit their import, export, transit, or transfer, throughout the entire territory, or in a part of the territory of Kosovo.</p>	<p>3.9. datum i vreme uvoza, izvoza, tranzita i prenosaa;</p> <p>3.10. vreme i mesto predviđenih zaustavljanja;</p> <p>3.11. ulazak i izlazak na graničnom prelazu i oblik prevoza ako je primenljivo;</p> <p>3.12. svrhu prenosa, ako je moguće.</p> <p>4. Dozvola za izvoz, tranzit i prenos važi za vremenski period od trideset (30) dana.</p> <p>5. Dozvola za uvoz, važi za vremenski period od devedeset (90) dana.</p> <p>6. MUP utvrđuje posebne mere bezbednosti za uvoz, izvoz, tranzit prelaz preko teritorije Republike Kosova.</p> <p>7. U slučaju ugrožavanja javne bezbednosti i za sprečavanje ilegalnog posedovanja i upotrebe pirotehničkih sredstava, MUP može ograničiti ili zabraniti njihov uvoz, izvoz, tranzit ili njihov prenos, na celoj teritoriji, ili na delu teritorije Kosova.</p>
---	---	--

<p align="center">Neni 47 Detyrimet e importuesve të artikujve piroteknikë</p>	<p align="center">Article 47 Obligations of importers of pyrotechnic articles</p>	<p align="center">Član 47 Obaveze uvoznika pirotehničkih sredstava</p>
<p>1. Importuesit vendosin në treg vetëm artikujt piroteknikë që përmbushin kriteret e përputhshmërisë.</p> <p>2. Përpara hedhjes në treg të artikujve piroteknikë, importuesit sigurohen që:</p> <p>2.1. prodhuesi të ketë kryer procedurat e vlerësimit të përputhshmërisë sipas përcaktimeve të këtij ligji;</p> <p>2.2. prodhuesi të ketë hartuar dokumentacionin teknik;</p> <p>2.3. artikulli piroteknik të ketë të vendosur shënjimin CE;</p> <p>2.4. artikulli piroteknik të shoqërohet me dokumentet e nevojshme për hedhjen në treg;</p> <p>2.5. prodhuesi të ketë plotësuar kriteret e përcaktuara në nenin 44 të këtij ligji.</p> <p>3. Kur importuesi vlerëson se një artikull piroteknik nuk është në përputhje me kërkesat kryesore të sigurisë të përcaktuara me këtë ligj, nuk e vendos në treg artikullin</p>	<p>1. Importers shall place only compliant pyrotechnic articles on the market.</p> <p>2. Before placing a pyrotechnic article on the market importers shall ensure that:</p> <p>2.1. the manufacturer has performed the conformity assessment procedures according to the provisions of this Law;</p> <p>2.2. the manufacturer has drawn up the technical documentation;</p> <p>2.3. the pyrotechnic article bears the CE marking;</p> <p>2.4. the pyrotechnic article is accompanied by the required documents for placing it on the market;</p> <p>2.5. the manufacturer has complied with the requirements set out in Article 44 of this Law.</p> <p>3. Where an importer considers that a pyrotechnic article is not in conformity with the essential safety requirements set out in this Law, he shall not place the pyrotechnic</p>	<p>1. Uvoznici stavljanju na tržište samo pirotehnička sredstva koja ispunjavaju kriterijume usklađenosti.</p> <p>2. Pre stavljanja pirotehničkih sredstava na tržište, uvoznici se obezbeđuju da:</p> <p>2.1. proizvođač je izvršio postupke procenjivanja usklađenosti prema utvrđenima ovog zakona;</p> <p>2.2. proizvođač je izradio tehničku dokumentaciju;</p> <p>2.3. pirotehničko sredstvo ima stavljenу oznaku CE;</p> <p>2.4. pirotehničko sredstvo se propratiti potrebnim dokumentima za stavljanje na tržište;</p> <p>2.5. proizvođač je ispunio kriterijume utvrđene u članu 44. ovog zakona.</p> <p>3. Kada uvoznik proceni da pirotehničko sredstvo nije u skladu sa glavnim bezbednosnim zahtevima utvrđenim ovim zakonom, neće staviti pirotehničko sredstvo</p>

<p>piroteknikë derisa të jetë në përputhje me kriteret e përputhshmërisë.</p> <p>4. Në rast se artikulli piroteknik paraqet rrezik, importuesi informon prodhuesin dhe MPB-në për rrezikun.</p> <p>5. Importuesit duhet të vendosin të dhënat si në vijim në artikujt piroteknikë:</p> <p>5.1. emrin e importuesit;</p> <p>5.2. emrin e regjistruar tregtar ose markën e regjistruar tregtare;</p> <p>5.3. adresën ku mund të kontaktohen.</p> <p>6. Nëse vendosja e të dhënave sipas paragrafit 5 të këtij neni nuk është e mundur, importuesi i vendos ato në paketim apo në një dokument shoqërues të artikullit piroteknik.</p> <p>7. Importuesit sigurohen që artikulli piroteknik të shoqërohet nga udhëzimet dhe informacioni për sigurinë në gjuhë zyrtare.</p> <p>8. Importuesit sigurohen që gjatë kohës që artikulli piroteknik është nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e magazinimit ose të transportit</p>	<p>article on the market until it has been brought into conformity.</p> <p>4. Where the pyrotechnic article presents a risk, the importer shall inform the manufacturer and the Ministry to that effect.</p> <p>5. Importers shall indicate on the pyrotechnic article the following:</p> <p>5.1. name of importer;</p> <p>5.2. registered trade name or registered trade mark;</p> <p>5.3. postal address at which they can be contacted.</p> <p>6. Where it is not possible to place the data according to paragraph 5 of this Article, the importer must place it on the packaging or in a document accompanying the pyrotechnic article.</p> <p>7. Importers must ensure that the pyrotechnic article is accompanied by instructions and safety information in the official language.</p> <p>8. Importers must ensure that while the pyrotechnic article is under their responsibility, the conditions of storage or</p>	<p>na tržište sve dok ne bude u skladu sa kriterijumima usklađenosti.</p> <p>4. U slučaju da pirotehničko sredstvo predstavlja opasnost, uvoznik informiše proizvođača i MUP-a o opasnosti.</p> <p>5. Uvoznici moraju staviti podatke kao u nastavku na pirotehnička sredstva:</p> <p>5.1. ime uvoznika;</p> <p>5.2. registrovano trgovinsko ime ili registrovanu trgovinsku marku;</p> <p>5.3. adresu gde se mogu kontaktirati.</p> <p>6. 4. Ako postavljanje podataka prema stavu 5. ovog člana nije moguće, uvoznik ih stavlja na pakovanju ili na prateći dokument pirotehničkog sredstva.</p> <p>7. Uvoznici se obezbeđuju da se pirotehničko sredstvo proprati uputstvima i informacijom o bezbednosti na službenom jeziku.</p> <p>8. Uvoznici se obezbeđuju da tokom vremena dok je pirotehničko sredstvo pod njihovom odgovornošću, uslovi skladištenja ili prevoza ne ugrožavaju ispunjenje</p>
---	--	--

